

V E N D I M
Nr.4, datë 9.1.1995

**PËR ULJEN E ÇMIMIT TË BANESAVE TË NDËRTUARA ME FONDE SHTETËRORE NË
RASTET E PAGESËS SË MENJËHERSHME NGA BLERËSIT**

Me propozimin e Ministrisë së Ndërtimit dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Kur pagesa e apartamenteve të ndërtuara me fonde shtetërore bëhet nga ana e blerësve në mënyrë të menjëhershme, çmimi total i apartamentit, i llogaritur sipas kriterëve në fuqi, zbritet 30 për qind.
2. Diferenca e shpenzimeve të mësipërme përballohet nga buxheti i shtetit.
3. Pika 5 e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.291, datë 21.6.1994, dhe pika 1 e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.421, datë 22.8.1994, shfuqizohen.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi